

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**SKELETKURRIKULI**

**Për Profilin Mësimor**

**RROBAQEPËSI**

**Niveli II**

**(Në drejtimin mësimor  
TEKSTIL-KONFEKSIONE)**

**Kodi: D1-II-18**

Miratoi:

**MINISTRI**

**Tiranë, 2018**

## **Përmbajtja:**

**I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II, të drejtimit mësimor “Tekstil-Konfeksione”.**

**II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II.**

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II.

**III. Plani mësimor për profilin “Rrobaqepësi”, niveli II.**

**IV. Udhëzime për planin mësimor**

**V. Udhëzime për procesin mësimor.**

**VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

**VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II,**

**VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.**

**IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar.**

**X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar.**

## **I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”.**

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II, të drejtimit “Tekstil-Konfeksione”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me fushën e rrobaqepsisë. Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:*

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehitë, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

## **II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II**

### **1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II**

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Rrobaqepësi” niveli II, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Tekstil-Konfeksione”, niveli I;
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paaftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

### **2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim arsimit në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Rrobaqepësi”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.

- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

### **3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Rrobaqepësi”, niv. II**

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Tekstil-Konfeksione”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin I, si dhe të ushtrtojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të përcaktojë pikat antropometrike në trupin e njeriut;
- Të dallojë difektet në trupin e njeriut;
- Të vizatojë portretin dhe pjesët e tij;
- Të vizatojë bustin dhe gjymtyrët;
- Të gjejë aksin e lëvizjes së trupit;
- Të vizatojë figurën e njeriut në lëvizje;
- Të përdorë tabelat e përmasave;
- Të zmadhojë dhe të zvoglojë kallëpet bazë, bazuar në sistemin koordinativ;
- Të llogarisë koeficientin e elasticitetit të trikotazheve.
- Të skicojë modelin për veshje të sipërme dhe të brendëshme;
- Të përzgjedhë materialet e punës;
- Të ndërtojë kallëpet me shenjat përkatëse të referimit për veshje të sipërme dhe të brendëshme;
- Të zgjedhë pëlhurën, penjtë dhe aksesorët e përshtatshëm për modelin përkatës të veshjeve të sipërme dhe të brendëshme
- Të presë veshje të sipërme dhe të brendëshme;
- Të qepë veshje të sipërme dhe të brendëshme
- Të kryej provën e qëndrimit në trup për veshje të sipërme;
- Të korrigjojë defekte të bustit, mëngëve, jakave, fundeve dhe pantallonave;
- Të dekorojë veshjet;
- Të kryejë proceset përfundimtare të konfeksionimit të veshjeve të sipërme dhe të brendëshme;
- Të kontrollojë kryerjen e punimeve;
- Të respektojë standartet e profesionit;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së ambientit të punës;
- Të përdorë në mënyrë të pavarur literaturat profesionale.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike për veprimtarinë e rrobaqepsisë.

#### 4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Rrobaqepësi”, niveli II.

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës si rrobaqepës dhe si kostumier në reparte industriale dhe artizanale.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

### III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Rrobaqepësi”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Rrobaqepësi”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
<b>A.</b>		<b>Lëndët e përgjithshme</b> (Gjithsej)	<b>8/9</b> (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
<b>B.</b>		<b>Lëndët profesionale</b> (Gjithsej)	<b>7 (238)</b>
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-10-215-11	Bazat e prerjes	2
3	L-10-216-11	Bazat e qepjes	1
4	L-10-217-11	Teknikë vizatimi	2
<b>C.</b>		<b>Module të detyruar të praktikës profesionale</b> (Gjithsej)	<b>12</b> (408)
1	M-10-596-11	Konfeksionimi i veshjeve për gra shtatzana	68
2	M-10-597-11	Konfeksionimi i jelekut për femra	34
3	M-10-598-11	Konfeksionimi i jelekut për meshkuj	34
4	M-10-599-11	Konfeksionimi i xhaketave për femra	85
5	M-10-600-11	Konfeksionimi i xhaketave për meshkuj	68
6	M-10-601-11	Konfeksionimi i pardesysë për femra	68
7	M-10-602-11	Konfeksionimi i veshjeve për bebe	51
<b>D.</b>		<b>Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar</b> (Gjithsej)	<b>3</b> (102)
1	M-10-603-11	Korrigjimi i defekteve të veshjeve	51

2	M-10-604-11	Shumfishimi teknik i bazave të prerjes	51
3	M-10-605-11	Konfeksionimi i veshjeve të brendshme	51
4	M-10-606-11	Konfeksionimi i palltos për femra	51
		<b>Gjithsej A+B+C+D</b>	<b>30/31</b> (1020/ 1064)

#### IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Rrobaqepësi”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithëshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

#### V. Udhëzime për procesin mësimor.

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritetit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Rrobaqepësi”, niveli II.

Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehjet praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimit (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat*

kyçe, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Rrobaqepësi”.

Në rastin e nxënësve me aftësi të kufizuara, mësuesit duhet të përshtasin programet e lëndëve dhe përshkruesit e moduleve në përputhje me mundësitë e tyre, si dhe të krijojnë kushte për zbatimin e tyre.

## **VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet.**

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Rrobaqepësi”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve), të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e rrobaqepsisë, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

## **VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Rrobaqepësi”, niveli II**

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Rrobaqepësi”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar, etj.
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi:
  - rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
  - rezultatet e dy provimeve përfundimtare të Nivelit II.

## VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale.

### 1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementët kryesorë të saj
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore
- Të analizojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes
- Të shpjegojnë funksionet themelore të menaxhimit në biznes
- Të shpjegojnë se si funksionon tregu
- Të shpjegojnë veprimtaritë kryesore të bankave të niveleve të dyta
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut
- Të listojnë katër "P"-të e marketingut
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit.
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërës të tij.
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një aktiviteti sipërmarrës
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 - 68 orë

<b>Tema 1</b>	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
<b>Tema 2</b>	Kërkimi sipërmarrës dhe aktiviteti njerëzor	4 orë
<b>Tema 3</b>	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
<b>Tema 4</b>	Menaxhimi dhe organizimi i punës në biznes	10 orë
<b>Tema 5</b>	Tregu	7 orë
<b>Tema 6</b>	Paraja, bankat dhe krediti	7 orë
<b>Tema 7</b>	Njohuri për marketingun	5 orë
<b>Tema 8</b>	Legjislacioni dhe etika e biznesit	6 orë
<b>Tema 9</b>	Legjislacioni i punës	7 orë
<b>Tema 10</b>	Llogaritje të thjeshta ekonomike	9 orë
<b>Tema 11</b>	Aspekte të TIK-ut në biznes	2 orë

### 2. Lënda “Bazat e prerjes” (L-10-215-11). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e prerjes” kl. 12 - 68 orë.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e prerjes”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së jelekut për femra e meshkuj
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së jelekut për femra dhe meshkuj.



- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes xhaketës bazë e të modeluar për femra dhe meshkuj.
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së xhaketës bazë e të modeluar për femra dhe meshkuj.
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së palltos reglan për femra.
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së palltos reglan për femra.
- Të listojë karakteristikat trupore të fëmijëve sipas grup-moshave.
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së trupit bazë për bebe.
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së mëngës dhe jakës për bebe
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së trupit bazë, mëngës dhe jakës për bebe;
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së fustanit bazë për fëmijë.
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së fustanit bazë për fëmijë.
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së pantallonave bazë për fëmijë.
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së pantallonave bazë për fëmijë.
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së xhaketës.
- Të ndërtojnë skicat e prerjes së xhaketës për fëmijë.
- Të listojë karakteristikat e veshjeve të brendshme, si mbathje, kanatjere, reçipeta, rroba gjumi dhe T-Shirte
- Të tregojnë etapat për ndërtimin e skicave të prerjes së veshjeve të brendshme.
- Të përshkruaj llojet e defekteve të formës së trupit të njeriut.
- Të tregojnë teknikat e korrigjimit të këtyre defekteve.
- Të përshkruaj teknikat e zhvendosjes në sistemin koordinativ.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e prerjes”, kl. 12 - 68 orë**

<b>Tema 1</b>	Jeleku për femra	4 orë
<b>Tema 2</b>	Xhaketa bazë për femra	8 orë
<b>Tema 3</b>	Xhaketa e modeluar për femra	6 orë
<b>Tema 4</b>	Pallto regland për femra	6 orë
<b>Tema 5</b>	Jeleku për meshkuj	4 orë
<b>Tema 6</b>	Xhaketa bazë për meshkuj	8 orë
<b>Tema 7</b>	Xhaketa e modeluar për meshkuj	6 orë
<b>Tema 8</b>	Veshjet për fëmijë	6 orë
<b>Tema 9</b>	Veshjet e brendshme	4 orë
<b>Tema 10</b>	Defektet dhe korrigjimet e tyre	8 orë
<b>Tema 11</b>	Sistemi koordinativ	8 orë

**3. Lënda “Bazat e qepjes” (L-10-216-11). Kl. 12 – 34 orë**

• **Synimet e lëndës “ Bazat e qepjes”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “ **Bazat e qepjes**”, kl. 12, nxënësit duhet:

- Të rendisin etapat e qepjes së jelekut për femra dhe meshkuj
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së jelekut për femra dhe meshkuj
- Të rendisin etapat e qepjes së xhaketës për femra dhe meshkuj
- Të përshkruajnë teknikat e qepjes së proceseve të ndryshme të xhaketave për femra dhe meshkuj

- Të përshkruajnë proceset e qepjes së veshjeve për fëmijë si (fustan, pantallona kominoshe dhe paliçeta për bebe)
- Të rendisin teknikat e qepjes së veshjeve për fëmijë
- Të rendisin etapat e qepjes së veshjeve të brendëshme si (mbathje, kanatjere, rroba banje dhe T- shirt)
- Të përshkruajnë proceset e qepjes së veshjeve të brendëshme
- Të rendisin teknikat e qepjes së veshjeve të brendëshme.
- Të listojnë defektet në qepje
- Të përshkruajnë difektet në qepje.
- Të përshkruajnë teknikat e rregullimit të difekteve në qepje.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e qepjes”, kl. 12- 34 orë**

<b>Tema 1</b>	Qepja e jelekut	4 orë
<b>Tema 2</b>	Qepja e xhaketës për femra	8 orë
<b>Tema 3</b>	Qepja e xhaketës për meshkuj	6 orë
<b>Tema 4</b>	Qepja e veshjeve për fëmijë	6 orë
<b>Tema 5</b>	Qepja e veshjeve të brendëshme	6 orë
<b>Tema 6</b>	Difektet në qepje dhe rregullimi i tyre	4 orë

**4. Lënda “Teknikë vizatimi” (L-10-217-11). Kl. 12 – 68 orë**

• **Synimet e lëndës “Teknikë vizatimi”, kl. 12**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “**Teknikë vizatimi**”, kl 12, nxënësit duhet:

- Të ndertojnë përmasat e figurës së trupit njeriut.
- Të vizatojnë figurën e njeriut me përmasat e stilizuara.
- Të ndertojnë syrin, veshin gojën, hundën me përmasat e tyre.
- Të vizatojnë syrin, veshin, gojën, hundën në pozicione të ndryshme.
- Të vizatojnë portretin me përmasat e tij në pika të ndryshme vrojtimi.
- Të vizatojnë krahun, këmbën me përmasat e tyre në pozicione të ndryshme.
- Të vizatojnë forma të ndryshme të bustit me përmasat e tij në pozicione të ndryshme.
- Të vizatojnë aksin e mesit dhe vijat ndihmëse.
- Të interpretojnë në mënyre grafike figurën e njeriut.
- Të përshkruajnë rolin e figurës së njeriut në modë.
- Të vizatojnë lëvizjen e trupit të njeriut nëpërmjet aksit të mesit.
- Të ndërtojnë figurën e stilizuar të trupit të njeriut.
- Të vizatojnë lëvizje të ndryshme mbi një bust të palëvizshëm.
- Të vizatojnë poza të ndryshme të figurës së trupit të njeriut.
- Të vizatojnë figura me lëvizje të përshtatshme për veshje të ndryshme.
- Të krijojnë veshje për ambiente të ndryshme duke përdorur ngjyrat.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Teknikë vizatimi” Kl.12 - 68 orë

<b>Tema 1</b>	Përmasat e njeriut	6 orë
<b>Tema 2</b>	Syri, hunda	6 orë
<b>Tema 3</b>	Veshi, goja	6 orë
<b>Tema 4</b>	Portreti	4 orë
<b>Tema 5</b>	Krahu, këmba	6 orë
<b>Tema 6</b>	Busti	4 orë
<b>Tema 7</b>	Figura e njeriut në modë	6 orë
<b>Tema 8</b>	Lëvizja dhe aksi i mesit në trupin e njeriut	6 orë
<b>Tema 9</b>	Figura e stilizuar e trupit të njeriut	6 orë
<b>Tema 10</b>	Poza të ndryshme të figurës së trupit (dinamike, statike)	6 orë
<b>Tema 11</b>	Lëvizje në përshtatje me veshje të ndryshme	12 orë

## IX. Përshkruesit e moduleve të detyruar të praktikës profesionale

### 1. Moduli “Konfeksionimi i veshjeve për gra shtatzëna”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KONFEKSIONIMI I VESHJEVE PËR GRA SHTATZËNA	M-10-596-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të konfeksionuar veshje për gra shtatzëna, sipas kallëpeve të skicuara.	
Kohëzgjatja e modulit	68 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi ndërton kallëpe për veshje për gra shtatzëna</b></p> <p><b>Përmbajtja</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës</li><li>- Skicimi i fundit për gra shtatzëna.</li><li>- Skicimi i kominosheve për gra shtatzëna.</li><li>- Skicimi i fustanit për gra shtatzëna.</li><li>- Kontrolli i skicave të veshjeve për gra shtatzëna.</li><li>- Prerja e kallëpeve të veshjeve për gra shtatzëna.</li><li>- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.</li><li>- Pastrimi i vendit të punës.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ndërtimin e kallëpeve</li><li>- të skicojë fundin për gra shtatzëna;</li><li>- të skicojë kominoshet për gra shtatzëna;</li><li>- të skicojë fustanin për gra shtatzëna;</li><li>- të kontrollojë saktësinë e skicave të prerjes mbi bazën e masave të marra;</li><li>- të presë kallëpet e veshjeve për gra shtatzëna;</li><li>- të vendosë shenjat përkatëse të referimit;</li></ul>	

- 
- të pastrojë vendin e punës;  
të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi pret kominoshe për gra shtatzëna.**

### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e pëlhurës.
- Shtrimi i pëlhurës
- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë.
- Shënimi i pjesëve të prera.
- Prerja e pëlhurës dhe materialeve ndihmëse.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e kominosheve për gra shtatzëna;
- të përzgjedhë pëlhurën për kominoshet që do të qepim
- të shtrojë pëlhurën
- të vendosë kallëpet
- të shënojë mbi pëlhurë; astar dhe frazelinë pjesët përkatëse;
- të presë pëlhurën dhe materialet ndihmëse sipas shënimeve;
- të pastrojë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 3 Nxënësi qep kominoshe për gra shtatzëna**

### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Kopjimi i shënimeve.
- Përgatitja e supanjës së pjesën së përparme.
- Përgatitja e supanjës së pjesën së prapme të kominosheve
- Përgatitja e xhepave pllakë të shpinës së kominosheve
- Përgatitja e xhepave anësore të përparme të kominosheve
- Qepja e pjesëve anësore, të mbrapme dhe të brendëshme të kominosheve.
- Qepja e hapjeve anësore të kominosheve.
- Bashkimi i supanjave me pjesët e përparme dhe pjesët e pasme të kominosheve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të kopjojë shënimet e duhura nga pjestët e lartme në ato të poshtme;
- të përgatisë supanjën e pjesës së përparme;
- të përgatisë supanjën e pjesës së prapme;
- të përgatisë xhepat pllakë të shpinës së kominosheve;
- të përgatisë xhepat anësore të përparës së kominosheve;
- të qepë pjesët anësore, të mbrapme dhe të brendëshme të kominosheve;
- të qepë hapjet anësore të kominosheve;
- të bashkojë saktë supanajat me pjesën e përparme dhe pjesën e pasme të kominosheve.
- të pastrojë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së kominosheve për gra shtatzëna**

***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Përgatitja e rripave për kominoshet.
- Qepja e rripave të kominosheve.
- Vendosja e rripave në trupin e kominosheve.
- Qepja e vrimave dhe kopsave.
- Hekurosja e kominosheve.
- Pastrimi i penjve.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet e duhura të punës;
- të përgatisë rripat për kominoshet;
- të qepë rripat e kominosheve;
- të vendosë rripat në trupin e kominosheve;
- të qepë vrimat dhe kopsat;
- të hekurosë kominoshet;
- të pastrojë penjtë;
- të pastrojë vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 5 Nxënësi llogarit çmimin e veshjeve për gra shtatzëna.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e preventivit të veshjes.
- Përlllogaritja e kostos së veshjes.
- Përlllogaritja e çmimit për lloje të ndryshme veshjesh për gra shtatzëna
- Plotësimi i faturës për klientin
- Komunikimi me etikë me klientin

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e veshjes;
- të përlllogarisë koston e veshjes;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme veshjesh për gra shtatzëna;
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së veshjes së qepur;
- të komunikojë me etikë me klientin.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në ndërmarrje të konfeksionit.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e veshjeve per gra shtatzëna.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e veshjeve per gra shtatzëna .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demostrimit praktik të aftësive dhe njohurive të fituara.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Komploti i veglave dhe materialeve për modelimin, prerjen, qepjen e e veshjeve për gra shtatzëna .
  - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen e e veshjeve për gra shtatzëna .
-

## 2. Moduli “Konfeksionimi i jelekut për femra”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KONFEKSIONIMI I JELEKUT PËR FEMRA	M-10-597-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për prerjen, dhe qepjen e jelekut për femra.	
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi merr masat për jelekun për femra.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës për marrjen e masave.</li><li>- Përzgjedhja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse.</li><li>- Marrja e masave për jelekun.</li><li>- Kontrolli i masave të marra.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për marrjen e masave;</li><li>- të përzgjedhe lëndën e parë dhe materialet ndihmëse;</li><li>- të marrë masat në trupin e njeriut;</li><li>- të kontrollojë masat e marra;</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mjedisit.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi pret jelekun për femra.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.</li><li>- Ndërtimi i skicave të jelekut të thjeshtë.</li><li>- Kontrolli i skicave.</li><li>- Prerja e kallëpeve.</li><li>- Vendosja e shenjave të referimit</li><li>- Përgatitja e materialit për prerje.</li><li>- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë, astar dhe frazelinë.</li></ul>	



- Shënimi mbi pëlhurë, astar dhe frazelinë i pjesëve të jelekut.
- Prerja e pëlhurës, astarit dhe frazelinës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e jelekut;
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të jelekut;
- të kontrollojë saktësinë e skicave;
- të presë kallëpet e pjesëve të jelekut;
- të vendosë shenjat përkatëse të referimit
- të përgatisë materialin për prerje, duke e shtruar në tavolinë për prerje;
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë, astar dhe frazelinë, në drejtimin gjatësor të saj;
- të shënojë mbi pëlhurë astar dhe frazelinë pjeset e jelekut;
- të presë pjesët e jelekut në pëlhurë astar dhe frazelinë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së mjedisit;

**RM 3 Nxënësi përgatit jelekun për provë**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës
- Kopjimi i shënimeve
- Frazelinimi i përparëseve të jelekut
- Ildisja e pensave të jelekut
- Bashkimi i shpinës me përparëset
- Kryerja e provës së jelekut
- Rregullimi i jelekut
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e provës së jelekut për femra;
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme tek shpina dhe përparësja e jelekut;
- të frazelinojë përparëset e jelekut;
- të ildisë pensat e jelekut;

- të bashkojë me ildi shpinën me përparësen;
- të kryejë provën e qëndrimit në trup të jelekut;
- të rregullojë jelekun pas provës;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### **RM 4 Nxënësi qep jelekun për femra**

##### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës
- Përzgjedhja e materialeve të punës
- Përgatitja e xhepave
- Qepja e xhepave
- Qepja e mostrës në përparëset e jelekut
- Vendosja e astarit në pjesët e përparme
- Qepja e shpinës së jelekut
- Qepja e shpinës me përparëset
- Kthimi i jelekut
- Vendosja e shenjave të birave dhe kopsave
- Hapja e vrimave të kopsave
- Vendosja e kopsave
- Hekorosja e jelekut
- Pastrimi i jelekut
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe e mjetet e punës për qepjen e jelekut për femra;
- të përzgjedhë materialet e punës;
- të përgatisë xhepat;
- të qepë xhepat sipas shënimit;
- të bashkojë mostrat me pjesët e përparme të jelekut;
- të qepë astarin e me pjesët e përparme të jelekut;
- të bashkojë dy pjesët e shpinës së jelekut;
- të qepë shpinën me përparësen e jelekut;
- të realizojë kthimin e jelekut nga pjesa e mbarë;
- të shënojë vendet e birave dhe kopsave;
- të hapë vrimat e kopsave me aqineri;
- të vendosë kopsat;
- të hekurosë jelekun;
- të pastrojë jelekun nga penjtë;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno sanitare;

- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### **RM 5 Nxënësi llogarit çmimin e jelekut për femra.**

##### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e preventivit të jelekut .
- Përlllogaritja e kostos së jelekut të thjeshtë.
- Përlllogaritja e çmimit për lloje të ndryshme jelekësh
- Plotësimi i faturës për klientin
- Komunikimi me etikë me klientin

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e jelekut;
- të përlllogarisë koston e jelekut të thjeshtë;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme jelekësh;
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së jelekut të qepur;
- të komunikojë me etikë me klientin.

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe në ndërmarrje të konfeksionimit.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për modelimin, prerjen, dhe qepjen e jelekut për femra.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen, qepjen e jelekut për femra .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive që ata kanë fituar.

---

#### **Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave dhe materialeve për modelimin prerjen dhe qepjen e jelekut për femra.
  - Reparti i punës së rrobaqepësisë.
  - Lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e jelekut.
  - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepësisë e të tjera.
-

### 3. Moduli “Konfeksionimi i jelekut për meshkuj”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KONFEKSIONIMI I JELEKUT PER MESHKUJ	M-10-598-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për modelimin, prerjen, qepjen e jelekut për meshkuj.	
Kohëzgjatja e modulit	34 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi merr masat për jelekun për meshkuj.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës për marrjen e masave.</li><li>- Përzgjedhja e lëndës së parë dhe materialeve ndihmëse.</li><li>- Marrja e masave për jelekun.</li><li>- Kontrolli i masave të marra.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për marrjen e masave;</li><li>- të përzgjedhe lëndën e parë dhe materialet ndihmëse;</li><li>- të marrë masat në trupin e njeriut;</li><li>- të kontrollojë masat e marra;</li><li>- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>RM 2 Nxënësi pret jelekun për meshkuj.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.</li><li>- Ndërtimi i skicave të jelekut të thjeshtë.</li><li>- Vendosja e shenjave të referimit.</li><li>- Kontrolli i skicave.</li><li>- Prerja e kallëpeve.</li><li>- Përgatitja e materialit për prerje.</li></ul>	

- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë.
- Shënimi mbi pëlhurë i pjesëve të jelekut.
- Prerja e pëlhurës.
- Prerja e astarit dhe e frazelinës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e jelekut;
- të ndërtojë skicat e prerjes së pjesëve të jelekut;
- të vendosë shenjat përkatëse të referimit;
- të kontrollojë saktësinë e skicave;
- të presë kallëpin e jelekut sipas skicave;
- të hapë materialin në tavolinë për prerje;
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë në drejtimin gjatësor të saj;
- të shënojë mbi pëlhurë pjesët e jelekut;
- të presë pjesët e jelekut;
- të presë mostrat e astarit dhe frazelinës;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit dhe mbrojtjes së mjedisit;

**RM 3 Nxënësi përgatit jelekun për provë.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës.
- Kopjimi i shënimeve.
- Frazelinimi i përparësive të jelekut.
- Bashkimi i shpinës me përprësen.
- Kryerja e provës së parë.
- Rregullimi i jelekut.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për provën e jelekut;
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesa e lartme në atë të poshtme tek shpina dhe përparësja e jelekut;
- të frazelinojë përparëset e jelekut;
- të bashkojë me ildi shpinën me përprësen e supet;

- të kryejë provën e qëndrimit në trup të jelekut;
- të rregullojë jelekun pas kryerjes së provës;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### **RM 4 Nxënësi qep jelekun për meshkuj.**

##### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës për qepjen e jelekut për meshkuj.
- Përzgjedhja e materialeve të punës.
- Fiksimi i materialit ngjitës me pëlhurën.
- Përgatitja e xhepave.
- Qepja e xhepave.
- Vendosja e mostrës
- Vendosja e astarit në pjesën përpara.
- Qepja e shpinës në mes.
- Përgatitja e rripit.
- Vendosja e rripit në pjesën e belit.
- Qepja e shpinës me përparësen.
- Kthimi i jelekut nga e mbara.
- Vendosja e shenjës së kopsave.
- Hapja e vrimave të kopsave.
- Hekurosja e jelekut.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e jelekut për meshkuj;
- të përzgjedhë materialet e punës;
- të fiksojë si duhet materialin ngjitës me pëlhurën;
- të përgatisë xhepat;
- të qepë xhepat sipas shënimit;
- të bashkojë mostrat me pjesët përpara të jelekut;
- të qepë astarin me pjesët përpara të jelekut;
- të bëjë bashkimin e dy pjesëve të shpinës së jelekut;
- të përgatisë rripin me astar;
- të vendosë rripin në pjesën e prapme në pikën e belit;
- të qepë shpinën me përparësen e jelekut;
- të realizojë kthimin e jelekut nga pjesa e mbarë;
- të vendosë kopsat;
- të hapë vrimat e kopsave me makineri;

- të realizojë hekursjen e jelekut;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### **RM 5 Nxënësi llogarit çmimin e jelekut për meshkuj.**

##### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e preventivit të jelekut .
- Përlllogaritja e kostos së jelekut të thjeshtë.
- Përlllogaritja e çmimit për lloje të ndryshme jelekësh
- Plotësimi i faturës për klientin
- Komunikimi me etikë me klientin

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e jelekut;
- të përlllogarisë koston e jelekut të thjeshtë;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme jelekësh.
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së jelekut të qepur
- të komunikojë me etikë me klientin

---

#### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe në ndërmarrje të konfeksionimit.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për modelimin, prerjen dhe qepjen e jelekut për meshkuj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për modelimin, prerjen, qepjen e jelekut për meshkuj .
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive që ata kanë fituar.

---

#### **Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet,veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Komplet i veglave dhe materialeve për modelimin prerjen dhe qepjen e jelekut për meshkuj.
  - Reparti i punës së rrobaqepësisë.
  - Lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e jelekut.
  - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepësisë e të tjera.
-

#### 4. Moduli “Konfeksionimi i xhaketave për femra”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	<b>KONFEKSIONIMI I XHAKETAVE PËR FEMRA</b>	M-10-599-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të ndërtuar kallëpe për modele të ndryshme të xhaketave për femra, për të prerë dhe qepur xhaketën klasike për femra.	
Kohëzgjatja e modulit	85 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi ndërton kallëpe për modele të ndryshme të xhaketave për femra</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.</li><li>- Skicimi i xhaketës klasike.</li><li>- Skicimi i xhaketës së drejtë.</li><li>- Skicimi i xhaketës princeshë.</li><li>- Skicimi i xhaketës dopiopet.</li><li>- Skicimi i xhaketës me jakë shall.</li><li>- Skicimi i xhaketës me jakë shall dopiopet.</li><li>- Skicimi i xhaketës Sahariane.</li><li>- Skicimi i xhaketave sipas fantazisë.</li><li>- Kontrolli i skicave përkatëse.</li><li>- Prerja e kallëpeve.</li><li>- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.</li><li>- Pastrimi i vendit të punës</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ndërtimin e kallëpeve të xhaketave për femra.</li><li>- të skicojë xhaketën klasike, sipas modelit</li><li>- të skicojë xhaketën e drejtë.</li><li>- të skicojë xhaketën princeshë.</li></ul>	



- 
- të skicojë xhaketën dopiopet.
  - të skicojë xhaketën me jakë shall.
  - të skicojë xhaketën me jakë shall dopiopet.
  - të skicojë xhaketën Sahariane.
  - të skicojë xhaketa sipas fantazisë.
  - të kontrollojë skicat përkatëse.
  - të presë kallëpet.
  - të vendosë shenjat përkatëse të referimit;
  - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi pret xhaketën klasike.**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përgatitja e pëlhurës dhe astarit për prerje.
- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë dhe astar.
- Shënimi mbi pëlhurë dhe aatar i pjesëve të xhaketës.
- Prerja e pëlhurës, astarit dhe materialeve ndihmëse.
- Pastrimi i vendit të punës
- Komunikimi me etikë me klientin.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e veshjeve për bebe;
- të përlllogarisë koston e paliçetave për bebe;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme veshjesh për bebe;
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së pardesysë së qepur;
- të komunikojë me etikë me klientin.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepësisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për prerjen e veshjeve specifike për bebe dhe fëmijë të vegjël deri në 3-vjeç si dhe konfeksionimin e paliçetave për bebe.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për ndërtimin e kallëpeve të veshjeve për bebe si dhe qepjes së paliçetave për bebe.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi ndërtimin e skicave të prerjes dhe të kallëpeve të veshjeve specifike për bebe.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi qepjen e paliçetave.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- repart rrobaqepësie;
  - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;
  - lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e paliçetave;
  - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepësisë, etj në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

### 1. Moduli “Korrigjimi i defekteve të veshjeve”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KORRIGJIMI I DEFEKTEVE TE VESHJEVE	M-10-603-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për konstatimin dhe rregullimin e defekteve në veshje të ndryshme.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil – Konfeksion.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi rregullon defektet e balancës</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.</li><li>- Rregullimi i defekteve të trupit me shpinë të shkurtër.</li><li>- Rregullimi i defekteve të trupit me shpinë të gjatë.</li><li>- Rregullimi i defekteve të trupit me përparëse të bustit të shkurtër.</li><li>- Rregullimi i defekteve të trupit me përparëse të bustit të gjatë.</li><li>- Rivizatimi i kallëpeve të reja.</li><li>- Kontrolli i saktësisë së kallëpeve.</li><li>- Prerja e kallëpeve.</li><li>- Pastrimi i vendit të punës.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për rregullimin e defekteve të balancës së shpinës dhe përparësës;</li><li>- të rregullojë kallëpin bazë të shpinës për trup me shpinë të shkurtër;</li><li>- të rregullojë kallëpin bazë të shpinës për trup me shpinë të gjatë;</li><li>- të rregullojë kallëpin bazë të përparësës për trup me</li></ul>	

- 
- përparëse të bustit të shkurtër;
  - të rregullojë kallëpin bazë të përparësës për trup me përparëse të bustit të gjatë;
  - të rivizatojë kallëpet e reja;
  - të kontrollojë saktësinë e kallëpeve, nëpërmjet kontrollit të masave;
  - të presë kallëpet e reja;
  - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi rregullon defektet e supeve dhe të harkut të qafës**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Rregullimi i defekteve të trupit me supe të pjerrta.
- Rregullimi i defekteve të trupit me supe katrore.
- Rregullimi i defekteve të linjës së dekoltesë.
- Rivizatimi i kallëpeve të reja
- Kontrolli i saktësisë së kallëpeve.
- Prerja e kallëpeve e reja.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për rregullimin e defekteve të supeve;
- të rregullojë kallëpin bazë të shpinës dhe përparësës për trupin me supe të rëna;
- të rregullojë kallëpin bazë të shpinës dhe përparësës për trupin me supe katrore;
- të rregullojë kallëpin e shpinës dhe përparësës për dekoltenë (gjërësi të tepërt, të ngushtë)
- të rivizatojë kallëpet e reja
- të kontrollojë saktësinë e kallëpeve, nëpërmjet kontrollit të masave;
- të presë kallëpet e reja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 3 Nxënësi rregullon defektet e bustit (formës së trupit)**

### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.

- Rregullimi i defekteve të trupit me shpinë me hark.
- Rregullimi i defekteve të trupit me qëndrim me hark.
- Rregullimi i defekteve të trupit me gjoks të lartë.
- Rregullimi i defekteve të trupit me bark të dalë.
- Rivizatimi i kallëpeve të reja.
- Kontrolli i saktësisë së kallëpeve.
- Prerja e kallëpeve të reja.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli..

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për rregullimin e defekteve të bustit;
- të rregullojë kallëpin bazë të shpinës, për trupin me shpinë me hark;
- të rregullojë kallëpin bazë të shpinës dhe përparësës, për trupin me qëndrim me hark;
- të rregullojë kallëpin bazë të përparësës, për trupin me gjoks të lartë;
- të rregullojë kallëpin bazë të përparësës, për trupin me bark të dalë;
- të rivizatojë kallëpet e reja;
- të kontrollojë saktësinë e kallëpeve, nëpërmjet kontrollit të masave;
- të presë kallëpet e reja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi rregullon defektet në mëngë**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Rregullimi i defekteve të thellësisë së kokës së mëngës.
- Rregullimi i defekteve nga harku i gabuar i gavatursës.
- Rregullimi i defekteve të pjesës së përparme të kokës së mëngës.
- Rregullimi i defekteve të pjesës së pasme të kokës së mëngës.
- Rregullimi i defekteve të mëngës reglan.
- Rregullimi i defekteve të mëngës kimono.
- Rivizatimi i kallëpeve të reja.
- Kontrolli i saktësisë së kallëpeve.
- Prerja e kallëpeve të reja.
- Pastrimi i vendit të punës.

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për rregullimin e defekteve të mëngëve;
- të rregullojë defektin e thellësisë së kokës së mëngës;
- të rregullojë defekte nga harku i gabuar i gavaturës;
- të rregullojë defekte të pjesës së përparme të kokës së mëngës;
- të rregullojë defekte të pjesës së pasme të kokës së mëngës;
- të rregullojë defekte të mëngës reglan;
- të rregullojë defekte të mëngës kimono;
- të rivizatojë kallëpet e reja;
- të kontrollojë saktësinë e kallëpeve të rivizatuara, nëpërmjet kontrollit të masave;
- të presë kallëpet e reja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 5 Nxënësi rregullon defektet në funde**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Rregullimi i defekteve bazë të matjeve.
- Rregullimi i defekteve të formës dhe qëndrimit të trupit.
- Rregullimi i defekteve speciale për lloje të ndryshme fundesh.
- Rivizatimi i kallëpeve të reja.
- Kontrolli i saktësisë së kallëpeve.
- Prerja e kallëpeve të reja.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit :***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për rregullimin e defekteve të fundeve;
- të rregullojë defektet bazë të matjeve;
- të rregullojë defektet e formës dhe qëndrimit të trupit(bark,vithe);
- të rregullojë defektet speciale për lloje të ndryshme fundesh (veref, me pala, etj);
- të rivizatojë kallëpe të reja, pasi janë rregulluar defektet e konstatuara;

- të kontrollojë saktësinë e kallëpeve të rivizatuara, nëpërmjet kontrollit të masave;
- të presë saktë kallëpet e reja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 6 Nxënësi rregullon defektet në pantallona**

### ***Përmbajtja :***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Rregullimi i defekteve të thellësisë së kavallos.
- Rregullimi i defekteve të këndit të kavallos së prapme.
- Rregullimi i defekteve të gjërësive bazë.
- Rivizatimi i kallëpeve të reja.
- Kontrolli i saktësisë së kallëpeve të rivizatuara.
- Prerja e kallëpeve të reja.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit :***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për rregullimin e defekteve të pantallonave;
- të rregulloj defektin e thellësisë së kavallos, duke lëvizur linjën e belit në kallëpe;
- të rregullojë defektin e këndit të kavallos së prapme;
- të rregullojë defektin e gjërësive të belit dhe të vitheve;
- të rivizatojë kallëpet e reja;
- të kontrollojë saktësinë e kallëpeve të rivizatuara, nëpërmjet kontrollit të masave;
- të presë kallëpet e reja;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë;

---

### **Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe të organizohen vizita njohëse në reparte, apo atelie mode.
- Mësimdhënësi duhet të përdorë sa më shumë që është e mundur demonstrimet konkrete për llojet e defekteve në pjesë të veçanta të veshjeve dhe teknikat e rregullimit të tyre.
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për rregullimin e defekteve të ndryshme në veshje.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive që ata kanë fituar.



---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Kompleti i veglave dhe pajisjeve për rregullimin e defekteve.
- Kompleti i materialeve për rregullimin e defekteve.
- Mjetet marëse dhe shënuese.
- Udhëzues, rregullorë për kushtet teknike për modelimin, prerjen, qepjen, rregullimin e defekteve në veshje të ndryshme.

---

## 2. Moduli “Shumfishimi teknik i bazave të prerjes”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	SHUMFISHIMI TEKNIK I BAZAVE TË PRERJES	M-10-604-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i pajis nxënësit me aftësi praktike për shumëfishimin teknik të bazave të prerjes (sistemin koordinativ) së objekteve të ndryshme për veshje.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi ndërton skicat e prerjes së sistemit bazë për gjerësi gjoksi 48 cm, dhe lartësi trupi 164 cm (fustani për femra).</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës .</li><li>- Nxjerrja e masave të nevojshme.</li><li>- Ndërtimi i skicave bazë të prerjes së fustanit.</li><li>- Ndërtimi i skicës së prerjes së shpinës së fustanit.</li><li>- Ndërtimi i skicës së prerjes së përparësës së fustanit.</li><li>- Ndërtimi i skicës së prerjes së mëngës së fustanit.</li><li>- Kontrolli i skicave të prerjes.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për ndërtimin e skicave të prerjes;</li><li>- të nxjerrë masat e nevojshme nga tabelat e përmasave;</li><li>- të ndërtojë skicat bazë të prerjes së fustanit;</li><li>- të ndërtojë skicën e prerjes së shpinës së fustanit;</li><li>- të ndërtojë skicën e prerjes së përparësës së fustanit;</li><li>- të ndërtojë skicën e prerjes së mëngës së fustanit;</li><li>- të kontrollojë saktësinë e skicave të ndërtuara nëpërmjet</li></ul>	

- 
- kontrollit të masave;
  - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 2 Nxënësi ndërton skicën e shpinës së fustanit sipas llogaritjes së koordinatave të kërkuara.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përcaktimi i pikave kyçe të ndryshimit të përmasave në gjatësi (boshti OY).
- Përcaktimi i pikave kyçe në ndryshimin e përmasave në gjerësi (boshti OX).
- Llogaritja e ndryshimit të pikës në rrethin e qafës.
- Llogaritja e ndryshimit të uljes së supit.
- Llogaritja e uljes së harkut të gavaturës.
- Llogaritja e ndryshimit të masave në bel.
- Llogaritja e gjerësisë së vitheve.
- Llogaritja e ndryshimit në fund të fustanit.
- Ndërtimi i skicës së re sipas numërit të kërkuar të gjoksit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për ndërtimin e skicës së shpinës;
- të përcaktojë pikat kyçe të ndryshimit të përmasave në gjatësi (boshti OY);
- të përcaktojë pikat kyçe të ndryshimit të përmasave në gjerësi (boshti OX);
- të llogarisë ndryshimin e pikës në rrethin e qafës;
- të llogarisë ndryshimin e uljes së supit;
- të llogarisë uljen e harkut të gavaturës;
- të llogarisë ndryshimin e masave në bel;
- të llogarisë gjerësinë e vitheve;
- të llogarisë ndryshimin në fund të fustanit;
- të ndërtojë skicën e re, sipas numërit të kërkuar të gjoksit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 3 Nxënësi ndërton skicën e prerjes së përparëses, sipas llogaritjes së koordinatave të kërkuara.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës.
- Llogaritja e ndryshimit të gjerësisë së gjoksit.
- Llogaritja e rritjes së kamës së gjoksit të përparëses së

fustanit.

- Llogaritja e rritjes në harkun e qafës.
- Llogaritja e rritjes së gjerësisë së belit.
- Llogaritja e gjerësisë së vitheve.
- Ndërtimi i skicës së re të përparësës së fustanit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës, për ndërtimin e skicës së prerjes së përparësës;
- të llogarisë ndryshimin e gjerësisë së gjoksit të përparësës së fustanit;
- të llogarisë rritjen e kamës së gjoksit të përparësës së fustanit;
- të llogarisë rritjen e harkut të qafës;
- të llogarisë rritjen e gjerësisë së belit;
- të llogarisë gjerësinë e vitheve të përparësës së fustanit;
- të ndërtojë skicën e re të përparësës së fustanit, sipas numërit të kërkuar të gjoksit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 4 Nxënësi ndërton skicën e re të mëngës së fustanit, sipas numrit të kërkuar të gjoksit.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe e mjeteve të punës.
- Llogaritja e rritjes së kokës së mëngës në gjerësi.
- Llogaritja e zhvendosjes në vijën e brylit.
- Llogaritja e rritjes së mëngës në gjatësi.
- Përcaktimi i pikave të reja.
- Ndërtimi i skicës së kërkuar të mëngës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ndërtimin e skicave të mëngës së fustanit;
- të llogarisë rritjen e kokës së mëngës në gjerësi;
- të llogarisë zhvendosjen në vijën e brylit;
- të llogarisë rritjen e mëngës në gjatësi;
- të përcaktojë pikat e reja nga vizatimi bazë;
- të ndërtojë skicën e kërkuar të mëngës, sipas numrit të gjoksit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik e mbrojtjes mjedisit.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe në ndërmarrjet e konfeksionimit.
- Mësuesi/instruktori duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete të proceseve të prerjes së skicave bazë të shumëfishimit të skicave të reja për modele të ndryshme veshjesh..
- Nxënësit duhet të angazhohen në punë konkrete për llogaritjen e ndryshimeve në gjatësi dhe në gjerësi të masave, duke u nisur nga skicat bazë të një objekti të caktuar.
- Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për ndërtimin e skicave të reja të përfutuara nga llogaritjet.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik të aftësive dhe njohurive që ata kanë fituar.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet, veglat dhe materialet e mëposhtme:
- Repart rrobaqepësie,
  - Tabelat bazë të përmasave për grup-mosha të ndryshme.
  - Udhëzues rregullorë për kushtet teknike.
  - Pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepësisë, etj.
-

### 3. Moduli “Konfeksionimi i veshjeve të brendshme”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

#### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe Kodi	KONFEKSIONIMI I VESHJEVE TË BRENDSHME	M-10-605-11
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të realizuar procese të ndryshme të prerjes dhe qepjes së veshjeve të brendshme për meshkuj dhe femra	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p><b>RM 1 Nxënësi kryen proceset parapërgatitore për konfeksionimin e veshjeve të brendshme prej trikotazhi.</b></p> <p><b>Përmbajtja:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit të punës.</li><li>- Përgatitja e mjeteve të punës.</li><li>- Nxjerrja e masave nga tabela e përmasave.</li><li>- Llogaritja e koeficientit të elasticitetit.</li><li>- Përzgjedhja e materialeve kryesore dhe ndihmëse.</li><li>- Përzgjedhja e aksesorëve të ndryshëm.</li><li>- Skicimi i bluzave T-Shirt për femra e meshkuj.</li><li>- Skicimi i kanatjerje për femra e meshkuj.</li><li>- Skicimi i mbathjeve për femra e meshkuj.</li><li>- Skicimi i i reçipetave për femra.</li><li>- Skicimi i veshjeve të gjumit.</li><li>- Kontrolli i skicave përkatëse të prerjes.</li><li>- Prerja e kallëpeve.</li><li>- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.</li><li>- Pastrimi i vendit të punës.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli.</li></ul> <p><b>Kriteret e vlerësimit:</b></p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin e punës;</li><li>- të përgatisë mjetet e punës;</li><li>- të nxjerrë masat nga tabela e përmasave;</li></ul>	

- 
- të llogarisë koeficientin e elasticitetit kur veshja e brendshme do të bëhet prej trikotazhi.
  - të përzgjedhë materialet kryesore dhe ndihmëse.
  - të përzgjedhë aksesorë të ndryshëm, që ndihmojnë në skicimin e veshjeve të brendshme
  - të skicojë bluzat T-shirt për femra e meshkuj.
  - të skicojë kanatjeret për femra dhe meshkuj;
  - të skicojë mbathjet për femra dhe meshkuj
  - të skicojë recipetat për femra;
  - të skicojë veshjet e gjumit;
  - të kontrollojë skicat përkatëse të prerjes;
  - të presë kallëpet përkatëse;
  - të vendosë shenjat përkatëse të referimit;
  - të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
  - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për ndërtimin e skicave të prerjes së veshjeve të brendshme .

## **RM 2 Nxënësi pret veshjen e gjumit për femra.**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit të punës.
- Përgatitja e mejteve të punës
- Përzgjedhja e materialeve dhe aksesorëve.
- Shtrimi i pëlhurës së endur.
- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë.
- Shënimi i vijave të prerjes mbi pëlhurë.
- Prerja e pjesëve të sipërme në pëlhurë.
- Prerja e pjesëve të poshtme në pëlhurë.
- Vendosja e shenjave të referimit.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin e punës për prerjen e objektit;
- të përgatisë mjetet e punës;
- të përzgjedhë materialet dhe aksesorët;
- të shtrojë pëlhurën në tavolinën e prerjes;
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë;
- të kryejë shënimin e vijave të prerjes mbi pëlhurë;
- të presë pjesët e sipërme në pëlhurë;
- të presë pjesët e poshtme në pëlhurë;
- të vendosë shenjat e referimit;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat

- higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për prerjen e veshjes së gjumit për femra.

### **RM 3 Nxënësi qep veshjen e sipërme të rrobave të gjumit.**

#### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Përgatja e filetove verëf.
- Vendosja e tantellës në pjesën e gjoksit.
- Qepja e filetos së përparëses dhe shpinës së kanatjeres.
- Qepja e harkut të mënges me fileto
- Qepja e rripit me fileto.
- Qepja e shpinës me përparësen.
- Hekurosja e veshjes së përfunduar
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës;
- të përgatisë filetot verëf për kanatjeren;
- të vendosë tantellën në pjesën e gjoksit;
- të qepë fileton në pjesën e përparme dhe të shpinës së kanatjeres;
- të qepë harkun e mëngëve me fileto;
- të qepë rripin me fileto;
- të qepë shpinën me përparësen e kanatjeres;
- të hekurosë veshjen e përfunduar;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për qepjen e veshjes së sipërme të rrobave të gjumit.



#### **RM 4 Nxënësi qep veshjen e poshtme të rrobave të gjumit.**

##### ***Përmbajtja***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Qepja e shpinës me përparësen.
- Qepja e filetos në pjesën fundore.
- Bashkimi i kavallos.
- Vendosija e llastikut:
- Vendosija e rripit.
- Hekurosja e veshjes së poshtme.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit.

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e objektit me material trikotazhi;
- të qepë shpinën me përparësen në pjesën anësore;
- të qepë fileton në pjesën fundore;
- të bashkojë kavallon;
- të vendosjë llastikun;
- të vendosë rripin;
- të hekurosë veshjen e poshtme,
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë punës në repartin e përmbartimit të tekstileve sintetike.

#### **RM 5 Nxënësi llogarit çmimin e veshjeve të brendshme për femra dhe meshkuj.**

##### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e preventivit të veshjes.
- Përlllogaritja e kostos së veshjes.
- Përlllogaritja e çmimit për lloje të ndryshme veshjesh të brendëshme për femra dhe meshkuj.
- Plotësimi i faturës për klientin
- Komunikimi me etikë me klientin

##### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

##### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e veshjes;
- të përlllogarisë koston e veshjes;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme veshjesh trikotazh;
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së veshjes

- trikotazh të qepur;
- të komunikojë me etikë me klientin.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e rrobaqepësisë si dhe në ndërmarrje të konfeksonimit.
- Mesimëdhënësi duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrime konkrete për prerjen e mbathjeve, kanatiereve, bluzave T-Shirt për femra dhe meshkuj, reçipetave dhe rrobave të gjumit për femra si dhe qepjen e rrobave të gjumit për femra.
- Nxënësi duhet të angazhohet në punë konkrete për ndërtimin e kallëpeve të veshjeve të brendshme për pëlhura të endura dhe të trikotuara, për prerjen dhe qepjen e rrobave të gjumit për femra.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të zbatohet vlerësimi mbi bazën e demonstrimit praktik dhe njohurive që ata kanë marrë.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pasijet dhe materialet e mëposhtme:
- Lloje të ndryshme të teksileve prej trikotazhi.
  - Kompleti i veglave dhe i materialeve për modelimin, prerjen dhe qepjen e objekteve prej trikotazhi.
  - Udhëzues, rregullore për kushtet teknike për modelimin, prerjen dhe qepjen e objekteve me material trikotazhi.
-

#### 4. Moduli “Konfeksionimi i palltos për femra”

Drejtimi: Tekstil-Konfeksione

Profili: Rrobaqepësi

Niveli: II

Klasa: 12

##### PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	KONFEKSIONIMI I PALLTOS PER FEMRA	M-10-606-11
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që aftëson nxënësit për të ndërtuar kallëpe dhe për të qepur pallto të modeleve të ndryshme për femra.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor Tekstil-Konfeksione.	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<b>RM 1 Nxënësi ndërton kallëpe për modele të ndryshme të palltove për femra</b> <b>Përmbajtja:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.</li><li>- Marrja e masave të nevojshme të palltos në trup.</li><li>- Përcaktimi i lirshmërisë së palltos.</li><li>- Skicimi i palltos monopet.</li><li>- Skicimi i palltos së lirshme.</li><li>- Skicimi i palltos dopiopet.</li><li>- Skicimi i palltos “Loden”.</li><li>- Skicimi i palltos “Rendigotë”.</li><li>- Skicimi i palltos “Montgomeri”.</li><li>- Skicimi i palltos “Reglan”.</li><li>- Skicimi i palltos “Kimono”.</li><li>- Kontrolli i skicave përkatëse.</li><li>- Prerja e kallëpeve.</li><li>- Vendosja e shenjave përkatëse të referimit.</li><li>- Pastrimi i vendit të punës.</li><li>- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Vëzhgim me listë kontrolli</li></ul> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për ndërtimin e kallëpeve të palltove për femra;</li><li>- të marrë masat e nevojshme në trup;</li><li>- të përcaktojë lirshmërinë për pallto;</li></ul>	

- të skicojë bazën e shpinës, përparëses, mëngës dy-copëshe dhe jakës së palltos monopet;
- të skicojë bazën e shpinës, përparëses, mëngës një-copëshe dhe jakës së palltos së lirshme;
- të skicojë bazën e shpinës, përparëses dhe jakës së palltos dopiopet;
- të skicojë bazën e shpinës, përparëses dhe jakës së palltos “Loden”;
- të skicojë bazën e shpinës, përparëses dhe jakës së palltos “Rendigoté”;
- të skicojë bazën e shpinës, përparëses dhe jakës së palltos “Montgomeri”;
- të skicojë bazën e shpinës, përparëses dhe mëngëve së palltos “Reglan”;
- të skicojë bazën e shpinës dhe përparëses dhe jakës së palltos “Kimono”;
- të kontrollojë saktësinë e skicave përkatëse;
- të presë kallëpet përkatëse;
- të vendosë shenjat e referimit në vendet e duhura;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 2 Nxënësi pret pallton dopiopet për femra.**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Shtrimi i pëlhurës, astarit dhe frazelinës për prerje.
- Vendosja e kallëpeve mbi pëlhurë, astar dhe frazelinë.
- Shënimi mbi pëlhurë, astar dhe frazelinë i pjesëve të palltos.
- Prerja e pëlhurës dhe astarit.
- Prerja e frazelinës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli.

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për prerjen e palltos;
- të shtrojë pëlhurën astarin dhe frazelinën për prerje;
- të vendosë kallëpet mbi pëlhurë, astar dhe frazelinë duke ekonomizuar lëndën e parë;
- të shënojë mbi pëlhurë, astar dhe frazelinë pjesët e palltos;
- të presë pjesët e palltos në pëlhurë dhe astar, sipas formës së vizatuar të kallëpeve;

- të presë në frazelinë jakën, mostrat, kapakët, filetata; fortesat e mëngëve dhe të fundit të palltos;
- të pastrojë vendin e punës duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### **RM 3 Nxënësi përgatit pallton dopiopet për provën e parë**

#### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Kopjimi i shënimeve në pjesët e palltos.
- Frazelinimi i përparëseve.
- Ildisja e pensave.
- Bashkimi me ildi i pjesëve të shpinës;
- Bashkimi me ildi i shpinës me përparëset e palltos;
- Vendosja e vatave të provës.
- Kryerja e provës së parë.
- Identifikimi i modifikimeve të mundshme gjatë provës
- Rregullimi i palltos pas kryerjes së provës së parë.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

#### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

#### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e palltos për provën e parë .
- të kopjojë me penjë-kopjues shënimet nga pjesët e lartme në ato të poshtme të palltos;
- të frazelinojë përparëset e palltos;
- të ildisë pensat e përparëses;
- të bashkojë me ildi pjesët e shpinës;
- të bashkojë me ildi shpinën me përparëset e palltos;
- të vendosë vatat e provës;
- të kryejë provën e parë të qëndrimit në trup të palltos;
- të identifikojë modifikimet të cilat janë të nevojshme në linjën e palltos, pensat, harkun e qafës si dhe të gavaturës;
- të rregullojë pallton pas kryerjes së provës së parë, duke hapur supet;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### **RM 4 Nxënësi përgatit pallton dopiopet për provën e dytë**

#### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.

- Qepja e xhepave oblikë.
- Hekurosja e xhepave.
- Qepja e shpinës.
- Hekurosja e shpinës.
- Frazelinimi i mostrave.
- Qepja e mostrave në përparëse.
- Kthimi i mostrave.
- Hekurosja e mostrave.
- Frazelinimi i harkut të gavaturës dhe qafës së shpinës.
- Qepja e mesit të shpinës dhe hapjes së saj.
- Hekurosja e shpinës.
- Bashkimi i shpinës me përparëset e palltos.
- Frazelinimi i jakës së poshtme.
- Qepja e jakës së poshtme.
- Dhënia e formë së duhur jakës së poshtme.
- Ildisja e jakës së poshtme të palltos.
- Frazelinimi i hapjes dhe fundit të mëngës.
- Qepja e dy pjesëve të mëngës.
- Bashkimi i mëngës.
- Hekurosja e rafive të mëngës.
- Ildisja e mëngëve në xhaketë.
- Përgatitja e astarit.
- Bashkimi i përparëseve të astarit me mostrat.
- Bashkimi i supeve të astarit.
- Hekurosja e astarit.
- Vendosja e vatave të provës në supe.
- Kryerja e provës së dytë të qëndrimit në trup të palltos.
- Identifikimi i defekteve të mundshme gjatë provës.
- Modifikimi i defekteve pas provës së dytë.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përgatitjen e palltos për provën e dytë;
- të qepë xhepat oblik në përparësen e palltos;
- të hekurosë xhepat e qepur;
- të qepë shpinën;
- të hekurosë shpinën;
- të frazelinojë mostrat;
- të qepë mostrat në përparëse, duke i dhënë mulesat e duhura;
- të kthejë mostrat nëpërmjet ildive;
- të hekurosë mostrat;
- të frazelinojë harkun e gavaturës dhe të qafës së shpinës;

- të qepë mesin e shpinës, dhe hapjen e saj;
- të hekurosë shpinën;
- të bashkojë shpinën me përparëset e palltos me makinë;
- të frazelinojë jakën e poshtme;
- të qepë jakën e poshtme;
- ti japë formën e duhur jakës së poshtme me hekur;
- të ildisë jakën e poshtme në pallto;
- të frazelinojë hapjen dhe fundin e mëngës;
- të qepë dy pjesët e mëngës sipas vijës së bërrylit;
- të kryej bashkimin e mëngës;
- të hekurosë rafitë e mëngës;
- të ildisë mëngët në xhaketë;
- të bashkojë pjesët e astarit me njëra-tjetrën, duke lenë një hapësirë në bashkimin e mëngës së majtë për kthimin e palltos;
- të bashkojë përparëset e astarit me mostrat;
- të bashkojë supet e astarit;
- të hekurosë rafitë e qepjes së astarit;
- të vendosë vatat e provës në supe;
- të kryej provën e dytë të qëndrimit në trup të palltos;
- të identifikojë defektet në qëndrimin e jakës dhe të mëngës, përcaktimin e gjatësisë së palltos dhe mëngëve;
- të modifikojë defektet e konstatuara pas provës së dytë të palltos;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 5 Nxënësi qep pallton dopiopet për femra**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Qepja e jakës së sipërme me atë të poshtmen
- Hekurosja e jakës;
- Montimi i jakës në harkun e qafës.
- Hekurosja e rafive të bashkimeve të jakës;
- Qepja e mëngëve;
- Hekurosja e kokës së mëngës.
- Vendosja e qeleshes.
- Vendosja e vatave.
- Kthimi i palës.
- Kthimi i fundit të mëngëve.
- Qepja e palës dhe kthesës së mëngës.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për qepjen e palltos;
- të qepë jakën e sipërme me të poshtmen duke i dhënë mulesa jakës së sipërme;
- të hekurosë jakën, duke u kujdesur që jaka e sipërme të mbulojë të poshtmen 1 mm;
- të montojë jakën në harkun e qafës, duke i qepur edhe mostrat, ndërsa me harkun e shpinës qepet vetëm pjesa e poshtme e jakës, duke lënë të lirë atë të sipërmen;
- të hapë me hekur bashkimet e jakës me trupin dhe mostrat;
- të qepë mëngët duke filluar nga cikajtja e poshtme e përparësës, duke i dhënë mulesa kokës së mëngës dhe duke bashkuar të gjitha shenjat e orientimit;
- të hekurosë me majën e hekurit mulesat e kokës së mëngës;
- të vendosë qeleshën duke e palosur atë dhe ta qepë brenda mëngës mbi tegelin e kokës së mëngës;
- të vendosë vatat në supe;
- të kthejë palën e palltos;
- të kthejë mëngët me ildi;
- të qepë palën dhe kthesën e mëngës duke lënë vend për bashkimin me astarin;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

## **RM 6 Nxënësi qep astarin në pallto**

### ***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Qepja e harkut të qafës së shpinës së astarit me jakën;
- Qepja e astarit me palën e palltos dhe me hapjen e shpinës;
- Qepja e astarëve të mëngëve me kthesën e mëngës;
- Hekurosja e astarit.
- Fiksimi i jakës së sipërme me astarin;
- Fiksimi i astarit me gavaturën dhe rafitë anësore;
- Kthimi i palltos;
- Pastrimi i vendit të punës
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

### ***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

### ***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për përfundimin e qepjes së palltos;
- të qepë harkun e qafës së shpinës së astarit me jakën;
- të qepë astarin me palën e palltos dhe me hapjen e shpinës



- (cika);
- të qepë astarët e mëngëve me kthesën e mëngëve;
- të hekurosë astarin;
- të fiksojë jakën e sipërme me astarin;
- të fiksojë astarin me gavaturën dhe rafitë anësore;
- të kthejë pallton;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 7 Nxënësi kryen proceset përfundimtare të qepjes së palltos dopiopet**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës.
- Mbyllja e hapjes së mëngës.
- Zbukurimi i palltos.
- Qepja e vrimave të kopsave.
- Vendosja e kopsave.
- Hekurosja përfundimtare e palltos.
- Pastrimi i palltos.
- Pastrimi i vendit të punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli

***Kriteret e vlerësimit:***

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë vendin dhe mjetet e punës për kryerjen e proceseve përfundimtare të qepjes së palltos;
- të mbyllë me makinë hapjen e mëngës;
- të qepë tegelin e zbukurimit;
- të qepë vrimat e kopsave me makinë;
- të vendosë kopsat në vendet e duhura;
- të hekurosë pallton;
- të pastrojë pallton nga penjtë e qepjes;
- të pastrojë vendin e punës, duke respektuar rregullat higjieno-sanitare;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit.

**RM 8 Nxënësi llogarit çmimin e palltos së qepur.**

***Përmbajtja:***

- Përgatitja e preventivit të palltos.
- Përlllogaritja e kostos së palltos.
- Përlllogaritja e çmimit për lloje të ndryshme palltosh.
- Plotësimi i faturës për klientin
- Komunikimi me etikë me klientin

**Instrumentet e vlerësimit:**

- Vëzhgim me listë kontrolli

**Kriteret e vlerësimit:**

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatisë preventivin e palltos;
- të përlllogarisë koston e palltos;
- të përlllogarisë çmimin për lloje të ndryshme palltosh;
- të plotësojë faturën për klientin gjatë shitjes së palltos së qepur;
- të komunikojë me etikë me klientin.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet kryesisht në reparte të rrobaqepësisë
- Instruktori i praktikës, duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur ilustrime dhe demonstrime konkrete të proceseve për prerjen dhe qepjen e palltos se thjeshte për femra.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e veprimeve për prerjen dhe qepjen e palltos për femra.
- Instruktori i praktikës duhet të mbikëqyrë respektimin e rregullave të sigurimit teknik, të mbrojtjes së mjedisit dhe mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi prerjen e pjesëve përbërëse të palltos, astarëve në pëlhurë dhe fortesë.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve, duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e veprimeve mbi qepjen e palltos për femra.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- repart rrobaqepsie;
  - pajisjet dhe mjetet e punës së rrobaqepësit;
  - lëndë të para dhe ndihmëse për prerjen dhe qepjen e palltos për femra.
  - pankarta, makete, udhëzues, katalogë të rrobaqepësisë, etj.
-